



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.03.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Shqyrtimi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën"" (*komision përgjegjës*)

Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën"" (*komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Gjetan Gjetani, Arben Pëllumbi, Dritan Bici dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Eglantina Gjermani dhe Lefter Koka.

Mungojnë:

Tatiana Nurçe, Lorenc Luka, Robert Bitri, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Roland Kristo - Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Arian Palluqi - përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Muharrem Jazaj - Kryetar i Shoqatës së Akuakulturës

Vasil Jovani - Anëtar i Shoqatës së Akuakulturës

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje!

Sot në rendin e ditës kemi parashikuar shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën"". Janë të ftuar në komision zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zoti Roland Kristo dhe zoti Arian Palluqi, përfaqësues i ministrisë. Pas diskutimit në komision, do të realizojmë edhe dëgjuesën me grupet e interesit, që përfaqësohen nga kryetari i Shoqatës së Akuakulturës, Muharrem Jaze dhe anëtari i kësaj shoqate, Vasil Jovani.

Relator i komisionit është zoti Besnik Baraj, i cili mund të bëjë një prezantim të shkurtër dhe më pas, do të dëgjojmë edhe prezantimin e përfaqësuesve të ministrisë për të vazhduar me tej, me pyetjet dhe me diskutimet.

Besnik Baraj – Unë mendoj të bëhet fillimisht prezantimi nga të ftuarit. Unë kam kryesisht një diskutim të shkurtër në formë pyetjesh.

Niko Peleshi – Dakord.

Fillojmë me prezantimin e projektligjit nga të ftuarit e ministrisë.

Roland Kristo – Përshëndetje të gjithëve!

Ndryshimet që kemi sjellë sot, janë disa ndryshime të vogla në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën", që do të zgjidhin një ngërç, që ka ndodhur, sepse në këtë ligj ka një dispozitë bllokuese në ligj në lidhje me dhënien e lejeve të reja për aktivitetin e akuakulturës derisa të përfundojë dhe të miratohet studimi për zonat e përcaktuara për akuakulturën. Ligji nr. 103/2016 "Për akuakulturën" përcakton që do të bëhet një studim për të gjitha zonat e përshtatshme për akuakulturën dhe mbas kësaj do të jepen lejet e reja për zhvillimin e aktivitetit. Në fakt, ky lloj aktiviteti është zhvilluar në Shqipëri. Në kohën deri sa të përfundojë studimi i zonave për akuakulturën, ka disa subjekte, të cilave u mbaron leja ose u ka mbaruar dhe ato nuk kanë të drejtën për të riaplikuar për zgjatjen e afatit, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin aktual.

Ne kemi vendosur këtë dispozitë transitorë deri sa të përfundojë ky studim kompleks. Këtyre subjekteve do t'u mundësohet vazhdimi i aktivitetit me të njëjtat terma dhe me të njëjtat kushte dhe në momentin kur do të përfundojë studimi që do të përcaktojë se ku do të zhvillohet ose jo aktiviteti, do të merret mendimi ynë. Në rast se do të lejohen, ata do të ndjekin

dispozitat e ligjit për të bërë rinovimin e lejes. Në rast se nuk do të lejohen, ata do të bëjnë spostimin e koshave në një vend tjetër. Kjo është pjesa e parë e ndërhyrjes, që bëhet në ligj.

Pika e dytë, ka të bëjë me futjen e konceptit të shoqatave dhe të organizatave të akuakulturës. Ne e kemi të përcaktuar te pjesa e ligjit të peshkimit, ku i njohim të gjitha shoqatat dhe organizatat e peshkimit.

Në ligjin "Për akuakulturën" kjo çështje mungonte. Pjesën e rregullores përkatëse të Bashkimit Europian që ka të bëjë me rregulloren 13/79 të vitit 2013, ne e kemi transpozuar te ligji "Për akuakulturën". Në këtë mënyrë shoqatat që ekzistojnë sot në Shqipëri në fushën e akuakulturës (përfaqësuesit e tyre sot janë këtu), ne do t'i njohim si partnerë zyrtarë edhe nga ministria.

Një tjetër ndërhyrje, që ka të bëjë me ligjin, është edhe përcaktimi i instalimeve në pronësi shtetërore. Këtu do të kemi parasysh, se do të bëhet studimi, por disa struktura shtetërore që janë në pronësi të Ministrisë së Bujqësisë ose të UBT-së, janë automatikisht pjesë e studimit. Unë nuk mund të them që impiantet e midhjeve në Butrint për të realizimin e të cilave është shpenzuar para, do të jenë apo nuk do të jenë pjesë, do të zhvillohet apo nuk do të zhvillohet aktiviteti i midhjeve në Butrint. Impianti i prodhimit të rasateve të koranit në Lin, i cili prodhon rasate për t'i lëshuar në liqen përsëri është një aktivitet i akuakulturës, natyrisht do të jetë pjesë e studimit të zonave të përcaktuara të akuakulturës, sikurse edhe qendra e prodhimit të rasateve të krapit me qëllim ripopullimin e liqenit të Prespës apo qendra e Tapizës në pronësi të UBT-së. Këto struktura që janë në pronësi të shtetit, janë automatikisht pjesë e studimit, pra nuk janë pjesë e rinegociimit me ministrinë e linjës për faktin që do të zhvillohet apo nuk do të zhvillohet aktiviteti në këto struktura.

Kjo për faktin se këto janë politikat. Për Butrintin të gjithë e dimë se në atë kohë (para viteve '90), janë shpenzuar rreth 1 milion dollarë, që po t'i kthejmë sot kanë një vlerë tjetër. Impianti i prodhimit të rasateve të koranit në Lin, që ka për qëllim ripopullimin e liqenit dhe nuk ka qëllim rritjen e peshkut për konsum, por vetëm për përmirësimin e statusit të stokut në liqenin e Pogradecit e po kështu, edhe qendra e prodhimit të rasateve të krapit me qëllim popullimin e liqenit të Prespës. Këto automatikisht janë pjesë e studimit.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Tani ia jap fjalën relatorit Baraj. Më pas do të kalojmë në pyetje dhe në diskutime.

Besnik Baraj - Ju falënderoj, kryetar!

Ju me të drejtë thatë se është krijuar një ngërç në ligjin aktual dhe prandaj ka ardhur ky projektligj.

E para, a do të ishte më mirë që të ishte një dispozitë kalimtare në mënyrë që ta zgjidhnim këtë ngërç dhe pastaj kjo të mos depozitohet në ligjin themelor? Pra, nëpërmjet kësaj zgjidhet problematika që ju thoni dhe pastaj mbasi të zgjidhet, nëpërmjet dispozitës kalimtare, ajo bie automatikisht.

E dyta, në rregulloren 13/79 të vitit 2013 të BE-së të gjitha çështjet që përbëjnë ngërç, parashihen. Cila është arsyeja që në ligjin e vitit 2016 ju nuk i keni marrë parasysh në mënyrë që të mos na shfaqej sot ky ngërç?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonat e përbashkëta të akuakulturës, me sa shoh, nuk janë miratuar akoma, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne në vitin 2016, kur kemi parashikuar hyrjen në fuqi të këtij ligji, kishim vënë një afat 2-vjeçar për miratimin e tyre. Cila është arsyeja që nuk janë miratuar edhe pse kanë kaluar 3-4 muaj nga ky afat?

Me sa kuptoj nga analiza, problemi kryesor, që është bërë shkak për sjelljen e këtij projektligji është problematika me kontratat e përfunduara, ato që priten të përfundojnë, si dhe impiantet e lira që mund të jepen me proces konkurrues në kushtet kur dhënia dhe rinovimi i tyre lidhet ngushtësisht me miratimin e zonave të përbashkëta të akuakulturës.

Me sa pashë nga vlerësimi i raportit bashkëlidhur, në relacion ju keni përcaktuar një afat, që është viti 2019. Si është situata? Kjo është komplementare me pyetjen paraardhëse.

Ju folët për instalimet në pronësi shtetërore. Ndërkohë, futët edhe një term tjetër, “instalim tokësor”. A ka nevojë të përkufizohen këto instalime tokësore? Mos janë sinonime dhe e bëjnë ligjin konfuz, duke përdorur dy terminologji që, si të thuash, në dukje janë të ndryshme, por që shprehin të njëjtën gjë?

Këto ishin pak a shumë pyetjet e mia.

Sigurisht, prania edhe e grupeve të interesit do të jetë me vlerë. Nuk e di nëse grupet e interesit e kanë pasur në dispozicion ligjin, në mënyrë që, si të thuash, të arrijnë që ta tretin atë për të dhënë opinionin e tyre, ndonëse është i shkurtër dhe koha mund t'u mjaftojë që t'i hedhin një sy. Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Robert Bitri – E para, në lidhje me grupet e interesit, zoti Jazaj, që është zëvendëspresidenti i Shoqatës së Akuakulturës, është edhe anëtar i komisionit konsultativ qendror të peshkimit dhe akuakulturës. Këtë amendament të ligjit ne e kemi nisur si rezultat i kërkesës së ardhur nga grupet e interesit. Kështu që do ta dëgjoni edhe në pjesën e dytë. Fakti ka qenë që këtyre subjekteve u është bllokuar aktiviteti ose janë në proces të bllokimit të aktivitetit dhe kërkojnë që ta vazhdojnë aktivitetin.

Në lidhje me pyetjen: a do të vendoset si dispozitë kalimtare ose në këtë formë?, në momentin që miratohen ZPA-të ose zonat e përcaktuara të akuakulturës, kjo dispozitë bie automatikisht. Pra, ne kemi kërkuar që derisa të përfundojë studimi, subjekteve që u ka mbaruar vlefshmëria e kontratës, ta vazhdojnë deri në miratimin e studimit. Pastaj në momentin që do të bëhet miratimi i studimit, që do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, është përfunduar... Pra, kjo dispozitë nuk ka më kuptim, sepse është përcaktuar dhe ligji do të futet pastaj në rrjedhën e tij, në nenet 13 dhe 15 të ligjit, i cili përcakton mënyrën e rinovimit ose të gjitha format e tjera.

Kjo është arsyeja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është pjesë pastaj që ose futen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juristët mendojnë të futet te neni 50 i ligjit, si një mënyrë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ka të bëjë më shumë me rregullat e teknikës legislative, si pjesë e natyrshme, sepse neni 50 është edhe dispozitë bllokuese. Ky është rast përjashtimor i të njëjtit nen, pra përjashton atë që thotë një pikë më lart e nenit të mësipërm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në lidhje me pyetjen: “Përse nuk u parashikua çështja e organizimit të shoqatave?”, në fakt, kjo ka qenë pjesë e një interpretimi ndërmjet juristëve në ministri: ligji i peshkimit, pavarësisht se është ligj i veçantë, i parashikon shoqatat, por nuk e ka të përcaktuar qartë, madje nuk e kishte deri para ndryshimeve që kaluam në muajin shkurt qartësisht: shoqata peshkimi, shoqata të akuakulturës. Në momentin e diskutimit juristët vendosën, pra quheshin si pjesë e përgjithshme, që do t’i përfshinin qoftë peshkimin, qoftë shoqatat e peshkimit, qoftë shoqatat e akuakulturës. Juristët kërkuan, nisur nga titulli, të ndahet në mënyrë të veçantë e gjithë pjesa e peshkimit. Pra, të mos kishte pjesën e përgjithshme, që mund të përfshinte edhe akuakulturën në çështjen e shoqatave, por edhe duke qenë se kemi ligjin e posaçëm për akuakulturën të kalohej në mënyrë të veçantë te pjesa e akuakulturës.

Në rast se ne do t’i shikojmë të gjitha amendamentet e bëra në lidhje me shoqatat, janë 99% të ngjashme me amendamentet që janë bërë te ligji i akuakulturës dhe tek ai i peshkimit. Pra, është pak a shumë përsëritje e amendamenteve të shoqatave te ligji i peshkimit. Është e njëjta gjë. Por duke qenë se kemi dy ligje të ndara, tani u vendosën në mënyrë të veçantë tek të dyja ligjet.

Në lidhje me studimin, ai është kompleks. Fakti që nuk përfundoi ose nuk ka përfunduar në detyrimin e vendosur, është qoftë për mungesën e burimeve të financimit, qoftë edhe për mungesën e një ekspertize të huaj.

Tani ka filluar projekti IPA i Bashkimit European, i cili është pak me vonesë, duhet të kishte filluar pak më parë, por detyrë të parë ky projekt ka përgatitjen e studimit. Ne shpresojmë që deri në fund të këtij viti të përfundojë studimi dhe të kemi bërë miratimin e tij në Këshillin e Ministrave. Është një proces...

Për sa i përket studimit, nuk është shumë, si të thuash, pjesa që mund ta vonojë, por pjesa që do ta vonojë më shumë do të jetë procesi i negocimit me të gjitha grupet e interesit. Kur them grupet e interesit, nuk e kam për operatorët tregtarë, por për të gjitha institucionet e tjera, të cilat kanë interes në det ose në ujërat e brendshme, si: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës...

Në fakt, me studimin do të ndajmë, si të thuash, zonat për secilën ministri. Kjo pjesë do të jetë nën përgjegjësinë e administrimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për akuakulturën, duke marrë parasysh se cilat janë interesat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si

dhe të të gjitha ministrive të tjera që kanë interes në det. Pra, ne do të ndajmë pjesën tonë, për të vijuar me procesin e lejimit të aktivitetit.

Besnik Baraj – Kam edhe diçka të vogël...

Niko Peleshi – Po, urdhëroni!

Besnik Baraj – ...që mund të jetë si paradoks në nenin 4 në lidhje me kontratat. Thuhet se kontratat që kanë skaduar do të lejohen deri në miratimin e ZPA-ve. Pastaj fillon një fjali, ku thuhet: “...vendosen kritere për miratimin e këtyre kontratave”. Mos ka ndonjë paradoks këtu, se po the që janë automatikisht të miratuara deri në miratimin e zonave të përbashkëta dhe pastaj për miratimin e tyre duhet të plotësohen këto kritere, më duket sikur nuk ka koherencë. A mos duhet ta rishikoni si pjesë?

Roland Kristo – E keni fjalën për fjalinë: “Kërkesa për zgjatjen e afatit të kontratës refuzohet në rast...”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e shoh. Ku është?

Robert Bitri – Pika 5 e nenit 4.

(Zotërinjtë flasin njëkohësisht.)

Besnik Baraj – Në pikën 5 ju thonin: “Këto kontrata konsiderohen të vlefshme deri në miratimin e ZPA-ve”, ndërkohë që në fjalinë pasardhëse thonin: “Zgjatja bëhet me kërkesën e subjektit...”, si dhe rendisni kriteret kur kjo zgjatje mund të refuzohet.

Roland Kristo – Po pra.

Besnik Baraj – Po thatë se i zgjatet afati deri në periudhën e miratimit të ZPA-ve dhe pastaj se duhet të plotësojnë kriterin...

Roland Kristo – Për ta refuzuar. Domethënë, refuzohet vetëm në rastet e parashikuara.

Pra, unë them kur... Nuk është automatikisht që atij subjekti do t’i zgjasë. Në rast se subjekti ka kryer shkeljet e përcaktuara ose nuk ka respektuar kushtet e përcaktuara në germë...

Besnik Baraj – Nuk bëhet fare objekt i kësaj pjese, them unë, sepse kur ka bërë shkelje, ti e ke marrë vendimin.

Roland Kristo – Jo, fakti është që në pjesën e vlerësimit të aktivitetit, domethënë ne do të kemi parasysh një gjë: edhe në rastin kur do të miratohet ZPA-ja..., se çfarë solli ligji? Unë kam një subjekt, i cili sot zhvillon aktivitetin e tij në një zonë të caktuar. Subjektit, i cili, në rast

se ka plotësuar të gjitha detyrimet kontraktore që ka pasur me kontratën e mëparshme, nuk ka pasur një ndikim, si të thuash, negativ mbi mjedisin, pra ka plotësuar një sërë kushtesh dhe kriteresh, automatikisht i rinovohet kontrata. Pra, nuk është më objekt negocimi me ministrinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm në rastet kur subjekti është dënuar, ka ndotur mjedisin, nuk ka marrë masa ose forma të tjera, atëherë ministria i thotë: “Jo, unë nuk ta rinovoj automatikisht”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord, por si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e verifikon ministria nëse plotësohen apo jo 3-4 kriteret e nenit 25. Subjekti bën kërkesën për zgjatjen e afatit. Neni thotë: Kërkesat për zgjatjen e afatit të kontratës refuzohen në rastet e parashikuara në germat “a” “b” “ç” dhe “d” të pikës 2 të nenit 25 të ligjit.

Roland Kristo – Në bazë të kërkesës që do të bëj subjekti ne do të shikojmë ka pasur apo jo gjoba. Në rast se subjekti nuk ka pasur, automatikisht do të kalojë paragrafi i mësipërm i të njëjtës pikë të ligjit. Megjithatë, kjo është pjesa që e ka shtuar Ministria e Drejtësisë. Në rast se ju doni ta hiqni, unë nuk kam ndonjë ...

Niko Peleshi – Jo, mund ta diskutojmë. Mirë është që të ketë kriteret, por duhet të jetë më e qartë. Kjo është ideja.

Neni 25.

Germa “a” thotë: “Ushtuesi i aktivitetit nuk ka përmbushur kërkesat për të cilat është lidhur kontrata”. Këtu duhet bërë një monitorim i kontratës.

Germa “b” thotë: “Ushtuesi i aktivitetit ka shkelur dispozitat e këtij ligji apo ka vepruar në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratë”. Duhet një monitorim që teorikisht bëhet nga ministria.

Germa “ç” thotë: “Kërkesat për rinovimin e kontratës bien ndesh me parimet e mbrojtjes së mjedisit sipas legjislacionit në fuqi”. Këtu do të kërkohet një raport audit, një vlerësim mjedisi i miratuar nga ministria apo diçka tjetër?

Roland Kristo – Në rast se statusi i zonës ka ndryshuar nga pikëpamja mjedisore, atëherë i thuhet që unë nuk mund ta rinovoj në mënyrë automatike.

Niko Peleshi – Dakord, por do t’i kërkohet një evidencë.

Roland Kristo – Do të bëhet një vlerësim i ndikimit në mjedis ose i lejes mjedisore. Duhet të keni parasysh që lejet mjedisore sot janë pa afat. Subjektet janë të detyruara të bëjnë monitorimin e vazhdueshëm sipas kushteve që i kanë të përcaktuara në lejen e tyre mjedisore. Në këtë kontekst, në rast se në atë zonë ka një impakt negativ, nga pikëpamja mjedisore automatikisht unë nuk mund t'ia rinovoj lejen. Do të presim studimin dhe kjo punë do të vazhdoj pasi të përfundojë studimi.

Niko Peleshi – Dakord. Vazhdojmë me pyetjet.

Robert Bitri – Ju thoni që do të mbarojë njëherë studimi dhe pastaj do të shpallen zonat. Afati ka kaluar. Kur mendoni ju të caktoni zonat, jo studimin? Studimi ju shërben juve të caktoni zonat.

E dyta, pse i ndani ministritë? Në fund, të gjitha ministritë përfaqësojnë qeverinë. Besoj se kjo do të bëhet me vendim qeverie, ndaj të gjitha ministritë, secila në pjesën e vet, duhet të japin mendimin e tyre kur të përcaktohen zonat. Zona të quhet e kualifikuar, e rregullt ose s'kualifikohet. Kështu që, nuk ka pse të shpallet dhe pastaj të japë mendimin e vet secila prej ministrive. Kur të dalë vendimi i qeverisë duhet të jenë mbyllur të gjitha gjërat. Të mos flasim pasi të dalë vendimi i qeverisë, sepse e kemi zakon të bëjmë ndryshime ligjore.

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Beqaj dhe pastaj zoti Marto.

Ilir Beqaj – Së pari, kryetar, do të doja të vinim rregull në vijimësi, që kur vijnë projektligje të kësaj natyre nga cilado ministri, duke qenë se jemi njerëz që nuk punojmë çdo ditë në atë sektor, qeveria të na sjellë më parë një material më të plotë për zhvillimin e sektorit dhe problematikat e tij.

E dyta, është e qartë që ky komision nuk ka punuar siç duhet në vitin 2016, sepse këto gjëra duhet të ishin bërë që atëherë. Tani nuk kemi çfarë të bëjmë, duhet të korrigjojmë edhe këto lloj gjërash.

E treta (këtu e dua përgjigjen në moment, sepse dua të vazhdoj arsyetimin), studimi që po bëni tani, ku me të drejtë përfshihen edhe ministri të tjera, do të përfshijë vetëm zonat e akuakulturës apo gjithçka që ne do të bëjmë me detin tonë?

Roland Kristo – Ne marrim përsipër vetëm zonat e akuakulturës.

Ilir Beqaj – Nëse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të thotë që mund kërkoj naftë në det, duhet ta thotë para se të dalë VKM-ja?

Roland Kristo – Nëse do të jetë për Ministrinë e Bujqësisë, apo për mua si përfaqësues i akuakulturës, unë e mbush të gjithë detin me kosha dhe impiante midhjesh, por, Ministria e Mjedisit thotë jo, sepse është zonë e mbrojtur, kam strategjinë apo kërkimin e naftës. Jo, se kam ndër mend ta bëj, por do të bëhet mbi bazën e dokumenteve të shkruara.

Ilir Beqaj – E kuptova. Faleminderit!

A ka kaluar ky ligj në procesin ligjor të konsultimit publik, sepse relacioni nuk e thotë? Pyetjet e tjera, që janë pak më të përgjithshme, nuk lidhen detyrimisht me amendimet, por me sektorin. Në cilin grup biznesi futen ata që ushtrojnë biznesin e akuakulturës? Sa biznese të tillë janë aktivë sot në Shqipëri? Sa të punësuar ka në këtë sektor? Sa ton kanë prodhuar? Nëse nuk keni të dhëna për vitin 2018, sepse mbase s'ka dalë akoma, na thoni për vitin 2017. Cila është vlera e të ardhurave? Ky që prodhon rasat në Tapizë është publik, apo jo? Kush ia cakton çmimet atij? Mua m'u desh rasat për kooperativën e peshkimit në Ulëz, por rasati ishte më i shtrenjtë se peshku.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mua më duheshin 20 milionë lekë për të gjithë liqenin e Ulzës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptova. Faleminderit!

Ndërkohë, që të mos e zgjas më shumë, për mendimin tim, kur të miratohet VKM-ja e zonave, subjekteve që po punojnë duhet t'u lëmë edhe 1 vit kohë të vazhdojmë punën dhe të mos jua ndërpresim atë ditë që do të miratohet VKM-ja. Ne nuk jemi të zotë t'u themi atyre për shembull që në datën 20 maj 2020 e kemi të mbaruar, që ai ta mendoj. VKM-ja do të dalë sot, do të botohet në Fletoren Zyrtare dhe për dy javë do të hyj në fuqi. Duhet t'i japim pak kohë biznesit. Unë sugjeroj që t'i lëmë 1 vit kohë.

Roland Kristo – Nuk do të ndodhë një gjë e tillë, sepse subjekti...

Ilir Beqaj – Mund të ndodhë, sepse do të thuash që këtë nenin e kërkoi drejtësia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e di që ke eksperiencë në administratë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dimë. Për shembull, po t'i pyesni sot këta...

Ilir Beqaj – Thelbi i ligjit është i mirë. Keni marrë rregulloren, te zbatimi shqiptar krijohet kaçurreli...

Roland Kristo – Duhet të kemi parasysh një gjë, zotëria ka hedhur sot peshk rasat, i cili do 18 muaj për t'u rritur...

Ilir Beqaj – Do të hedhë edhe në vjeshtë ai...

Roland Kristo – Vetëm se unë do t'i them: zotëri, nga kjo datë mos hidh më rasat për të rritur, mbaro peshkun që ke aty, pastaj do të largohesh që këtej.

Ilir Beqaj – Por do t'ia thuash kur të dalë VKM-ja. Atëherë do t'i lësh edhe kohën që peshku të riprodhohet...

Roland Kristo – Po, 18 muaj maksimumi...

Arian Palluqi – Nuk duhet t'i eliminojmë këto që janë. Mund të qëllojë dikush në Porto Palermo, se është shpallur zonë e mbrojtur, dhe ai është i detyruar. Ne gjirin e Vlorës e kemi zonë të mbyllur për peshkimin detar. Aty kultivohen në kosha. Nuk besoj, duke lënë mënjane pjesën e zonës së mbrojtur, Karaburunin dhe Sazanin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqë ju pyetët se sa subjekte janë, unë jam i detyruar t'jua them edhe subjektet. Po ju them se 7 janë në gjirin e Vlorës dhe 6 janë në Sarandë. Nuk ka më...

(Diskutime pa mikrofon)

Kultivimi në kosha bëhet pranë bregut. Pjesa më e madhe kështu e ka, për shembull Turqia dhe Greqia, por ka edhe *offshore*. Natyrisht, një aktivitet *offshore* kërkon investime shumë më të mëdha, sepse koshi duhet të përballojë një det deri në 7 ballë

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deri sot në Shqipëri janë vetëm *inshore*. Nesër edhe Shqipëria mund të ketë dhe do të ketë *offshore*. Sot që po flasim janë gjithsej 13 subjekte që prodhojnë, 7 janë në Vlorë dhe 6 në pak breg që ka Saranda. Pavarësisht se ligji në përcaktimin e azeve është pak diskriminues për peshkimin, sepse thuhet që duhet të merret dakordësia e mjedisit, e turizmit, ne propozojmë që zonat që janë të përshtatshme. Pastaj ministria tjetër do të bëjë selektimin, pra jemi në pozita pritëse. Unë di të them se, dhe kjo lidhet me pyetjen e zotit Beqaj për prodhimin, që ditën, kur është miratuar ligji, ne nuk kemi dhënë asnjë licencë të re. Atë vit, dhe unë nuk kam qenë, për të përjashtuar çdolloj konflikti interesi, janë dhënë vetëm dy licenca para se të hynte ligji në fuqi.

Këto dy licenca, njëra për troftë dhe tjetra për peshk detar, kanë bërë që prodhimi në vitet 2017 dhe 2018 të rritet dyfish. Për vitin 2018 kemi të raportuar 5500 tonë nga akuakultura në përgjithësi. Po të heqim një pjesë të midhjeve, sepse prodhimi i midhjes zakonisht lëviz, 1500 tonë këtë vit, vitin tjetër të shkon përnjëherë 100 tonë si rezultat i kushteve hidrologjike të liqenit të Butrintit, sepse mund të ndodhë një katastrofë, pra midhja është një problem, vetë akuakultura e kocës dhe e levrekut dhe e troftës nga ana tjetër, domethënë e ujit të kripur dhe ujit ëmbël, e ka grafikun në këtë formë. Fatmirësisht, ky nuk është vetëm një fenomen shqiptar, por edhe në të gjithë botën akuakultura vazhdon të ecë me këto ritme. Në qoftë se çdo prodhim bujqësor ka trendin e vet 2%-3%, akuakultura edhe në botë, në Shqipëri pak më shpejt, ecën me ritme të tilla, sepse natyra në det është e kufizuar dhe është gjetur kjo formë. Prodhimi, siç ju thashë, është 5500 tonë, që është goxha. Kur kam raportuar për vitin 2016, kemi qenë në nivelin e 3000 tonëve, sot, që jemi në nivelin 5500 tonë, është e ardhur vetëm nga dy subjekte. Kjo do të thotë që nesër, me miratimin e zonave, të shpresojmë që procesi të jetë inveres. Në qoftë se deri dje vinin subjektet dhe kërkonin të ushtronin aktivitet dhe unë si administratë u thosha të shohim, tani është e kundërta. Domethënë, ministria do të paraqesë zonat se ku mund të zhvillohet dhe bën thirrje. Të gjitha subjektet që janë të interesuara, do të vijnë të marrin pjesë. Duke filluar aktivitetin shpresojmë pastaj që edhe prodhimi të vazhdojë të rritet me këto ritme, natyrisht sa është edhe kapaciteti mbajtës për zona të caktuara.

Niko Peleshi – Fjalën e kanë kërkuar Andrea Marto, zoti Baraj dhe pastaj zoti Leka.

Andrea Marto – Çështja e subjekteve, që kanë realizuar investime të qenësishme, u prek edhe nga zoti Beqaj. Nuk bëhet fjalë vetëm për rasatin që e dimë sa muaj do, por mund të ketë subjekte që kanë bërë investime disavjeçare. Si parashikohet ta zgjidhni këtë, në qoftë se do t'i thuhet: këtu, ku ke investuar milionët nuk mund të jetë më zonë për këtë gjë? Do të ketë fazë kalimtare, do t'i jepet kohë, do të dëmshpërblehen? Atij ia ka dhënë dikush atë licencën për të bërë investimin afatgjatë. Faleminderit!

Edmond Leka – Në kuadër të pyetjes që bëri edhe zoti Marto, unë dua të di: a ka studim konkretisht për gjirin e Vlorës?

Para një viti, së bashku me zotin Baraj kemi diskutuar në parlament dhe kemi mbrojtur me forcë moszhvillimin e një biznesi shumë të madh, i cili, me sa ishim edhe ne në dijeni, kishte marrë edhe licencën për ushtrimin e aktivitetit në gjirin e Vlorës. Bëhet fjalë për mbi 100 hektarë

në det. Kjo gjë do të ishte shkatërrimtare për gjirin e Vlorës. A është e vërtetë që ka një biznes që ka një licencë të tillë për ushtrimin e këtij aktiviteti?

E dyta, në kuadër të pyetjes që bëri zoti Marto, në qoftë se ky studim do të përfundojë dhe shikojmë se në gjirin e Vlorës nuk mund të ushtrohen më aktivitete, si do të veprohet me bizneset që kanë investuar? A do të ketë një radhë? Pra, kush ka investuar i fundit, do të largohet i pari? Si do të veprohet, sepse janë milionë euro të investuara në gjirin e Vlorës? Ajo që më intereson më shumë është konkretisht licenca e këtij biznesi shkatërrimtar për gjirin e Vlorës. A ka licencë të tillë, apo jo? Përsëri nëpër biznese përflitet që, në qoftë se ky licencim do të fillojë të ushtrojë aktivitet, gjiri i Vlorës merr fund përfundimisht.

Besnik Baraj – Atëherë, unë dua ta trajtoj këtë në formë komenti, duke iu risjellë në vëmendje ju komentet që kemi bërë dy vjet më parë, kur është miratuar. Ka pasur një sensibilitet shumë të madh këtu, ndonëse nga ana e ministrisë suaj ka pasur një lloj trysnie qoftë në ministri, qoftë deri në Vlorë për licencimin dhe hapjen e këtij aktiviteti. Ndërkaq në ligjin që kemi formuluar në atë kohë kemi shtuar, më sa mbaj mend, një klauzolë, ku për zonat që janë afër zonave të mbrojtura, patjetër që duhet merret parasysh opinioni i ministrisë përkatëse. Duke rikujtuar atë problematikë, dua të ritheksoj se ju duhet të bëheni barrierë që në gjirin e Vlorës, për shkak të kapaciteteve rehabilituese që ka ky gji, që janë të vogla për shkak të qarkullimit të vogël të tij, duhet të parashikoni që të mos bëhen ndërtime të tjera, përveç këtyre që janë aktualisht. Atëherë kemi sjellë shembuj lidhur me misionin e substancave të ndryshme, që rrishte sasinë e nitrateve të fosfateve në ujën e detit. Për shembullin, që pas 10 apo 20 vjetësh gjiri i Vlorës do të jetë me ngjyrë jeshile, sepse do të favorizohen mikroalgat që do të zhvillohen aty. Prandaj nuk kemi arsye që ta djegim këtë bukuri për 2,5 apo 10 mijë tonë peshk, në një kohë që vendet e tjera bëjnë *offshore*, siç thatë edhe ju. Pra, të mos e bëjmë këtë punë, si puna e hidrocentraleve, ku japim hidrocentrale të vegjël, për shkak të favoreve që u bën shteti atyre në çmim. Edhe në këtë rast për shkak se këto biznese nuk duan të bëjnë investime të mjaftueshme për të pasur zhvillimin e këtij sektori *offshore*, ne i favorizojmë ata kundrejt, nuk aludoj për ju, por siç ka ndodhur rëndom në Shqipëri, favoreve të biznesit, por duhen hapur sytë, sepse ka edhe korrupsion. Kështu që, unë do të doja që ju të jeni shumë të vëmendshëm karshi atyre diskutimeve që kemi bërë 2 vjet më parë. Ne do të mbajmë të njëjtin qëndrim, të paktën unë, në lidhje me këtë problematikë. Faleminderit!

Roland Kristo – Së pari, ne u përqendruam te gjiri i Vlorës, ai është shumë i vogël në krahasim me atë që do të diskutohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, por po të shkojmë në Greqi, te kepi Stillos, 20 metra më tutje, po të njëjtin gjë kanë ata, por nuk ka rëndësi. Të mos përqendrohemi te gjiri i Vlorës, sepse gjiri i Vlorës është një pikë uji në atë që ne kemi.

Duhet të kemi parasysh se akuakultura është pjesa ku do të kemi të gjithë pjesën e burimit të proteinave me bazë peshku.

Po të bëjmë një krahasim me bujqësinë, peshkimi është si të shkosh dhe të dalësh për gjah, të vrasësh lepuj të egër, derra të egër apo kaproj, akuakultura është t'i rrisësh në femra: delet, lopët, derrat apo pulat.

Sot në bujqësi e gjitha është në drejtim të rritjes së tyre artificiale dhe jo të daljes...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po të shikojmë sot 85% e resurseve të peshkimit në Detin Mesdhe janë të mbishfrytëzuara, vetëm 15% janë në nivel shfrytëzimi të qëndrueshëm. Kështu që e ardhmja, jo vetëm në Mesdhe, por në të gjithë botën, është drejt akuakulturës.

Nga të gjitha të dhënat globale, shikojmë se peshkimi në nivel botëror është në rënie me 3,4%, kurse akuakultura është në rritje me 10%-15%, sepse po shkohet drejt akuakulturës. Rasti specifik i Vlorës, është një pjesë nga gjithë të tjerat. Duhet të keni parasysh vetëm një gjë: ne, si Ministri e Bujqësisë, jemi për një zhvillim të qëndrueshëm, sepse duke i krijuar të gjitha mundësitë subjektit, që të ketë një qartësim mbi të ardhmen e tij, ai do të bëjë biznes të sigurt. Unë nuk mund t'i kërkoj një subjekti që në një zonë cilës nuk i dihet statusi i saj, do të shkojë në drejtim të zonës së mbrojtur, do të ndërtohet një rrugë kalimi apo do të bëhet një zonë me një potencial të madh zhvillimi, të hedhë 10 apo 15 milionë euro dhe pas një periudhe disavjeçare t'i them: të lutem largohu që këtej. Ky është qëllimi pse ne po kërkojmë, si Ministri e Bujqësisë, të ndajmë përgjegjësitë me ministrinë e tjera. Do të ishte shumë e thjeshtë të vazhdohej me praktikën përpara se të hynte që në fillim ligji i vitit 2016. Unë e jap zonën dhe të them: zotëri merre dhe ministrinë e tjera do të bënin "luftë", unë e kam dhënë, jo e kam unë këtë e të tjera. Jo, ne duam që investimet në akuakulturë të jenë të qëndrueshme dhe afatgjate, që të zhvillohet ky sektor. Subjekti që do të investojë duhet të ketë garancinë që ky aktivitet do të jetë afatgjatë.

Natyrisht, janë lehtësuar edhe procedurat. Në rast se subjekti ka ndjekur të gjitha kushtet dhe detyrimet, që i ka të parashikuara në kontratë, nuk do të vijë me të rinegociojë me ministrinë, a do ta zgjasë apo nuk do ta zgjasë kontratën. Në qofte se një subjekt ka ndjekur të gjitha ato detyrime që ka pasur, ai mund të vazhdojë pa asnjë lloj problemi. Pra, në këtë për të dhënë këtë lloj garancie kërkojmë.

Në lidhje me lejen e dhënë për subjektin, që ju e kishit merak përgjigjen, nuk është ky problemi, por do të japim një përgjigje më të detajuar. Në rast se një subjekt... Po i kthehem përsëri një zone të caktuar për të cilin do të themi se në këtë zonë do të ketë një plan zhvillimi në fushën e turizmit, në të cilët sot kemi disa kosha, çfarë do të ndodhë me subjektin që ka investuar miliona euro? Në qoftë se studimi ka përcaktuar, që zona më tutje është atje, këto janë sisteme me kosha. Unë e di që ka kosto, por ne askujt nuk do t'i themi: mbylle sot aktivitetin dhe largohu, por do t'i them: "Mbaro lejen që të është dhënë, kohën që të është dhënë dhe pastaj ti, zotëri, këtu nuk e zhvillon dot më, por duhet të kërkohet në një nga zonat e tjera, të cilat janë të identifikuar si zona ku asnjë ministri tjetër nuk ka interesa afatshkurta, afatmesme apo afatgjate zhvillimi, por vetëm Ministria e Bujqësisë për zhvillimin e akuakulturës. Pra, ne do t'i themi investimin duhet ta spostoje 1 kilometër apo 1 milje më tutje.

Arian Palluqi - Në dijeninë time ka pasur një kërkesë, për të zhvilluar aktivitetet akuakulture për kosha në gjirin e Vlorës. Kur më është dhënë rasti unë kam qenë pro, pa qenë vendimmarrës si teknik. Unë edhe sot jam pro, sepse atë zanat kam, atë që tha pak më parë edhe Rolandi. Të jetë për mua nga Buna deri në kepi e Stillos unë e bëj zonë peshkimi atë. Më pas më thoni: "Jo, prit se ka interes më shumë nafta, hoteli me 5 yje e kështu me radhë".

Unë kam qenë pro, sepse subjekti përfaqësonte një nga më të mëdhenjtë në Europë dhe ka pasur një reagim qytetar në kuadrin e dëgjësave publike, në dijeninë time, në Bashkinë e Vlorës, ku një pjesë e mirë e njerëzve kanë qenë kundër, dhe ai nuk ka marrë leje në mjedis. Ndërkohë, po i njëjti biznes, ka kërkuar të zhvillojë kosha në liqenin e Fierzës apo të Komanit, dhe sot prodhon minimumi 1500 tonë në vit.

Për gjirin e Vlorës, me gjithë respektin, por edhe unë që jam mirëfill i atij zanati, nuk mund të them nëse jemi mbi kapacitet apo nën kapacitet. Kjo është një ndër arsyet që për të përcaktuar kapacitetet e të gjithë Vlorës, nuk do ta bëjë një shqiptar, le që nuk ka njerëz të specializuar, për të përcaktuar kapacitetet e një zone të caktuar ujore, pra kapacitetin mbajtës. Do

të marrim specialist të huaj, fatmirësisht nuk janë firma private, por është Këshilli i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun, do të sjellim grupin e akuakulturës dhe ata do të thonë: “Në gjirin e Vlorës, me këtë thellësi, me këto korente uji dhe me këtë shpejtësi që ka, kapaciteti prodhues është 20 mijë tonë, po them një shifër kot. Thëniet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, sepse do të jetë shkencërisht e vërtetuar. Unë kam qenë disa herë në Vlorë dhe ata e kanë me problem të madh, duke filluar që nga kryetari i bashkisë, por që unë personalisht nuk shoh... Po të bësh krahasime me të gjitha vendet e botës, vendet që kanë turizmin më të zhvilluar, kanë edhe këtë formë peshkimi akuakulture. Turqia, Greqia, Italia dhe Spanja janë vende turistike dhe turistët duan peshk çdo ditë, por peshk deti nuk mund të ketë për të gjithë, kështu që do të hanë koce dhe levrek. Fatmirësisht, Greqia ka shumë ishuj dhe mund të kenë peshk edhe për turistët. Për shembull, unë po marr si shembull Kakomenë, që po të ishte për mua duhet të kishte filluar me kosha në Kakome dhe të thoshim se turizmi do të zhvillohet. Ku jemi sot, ka 30 vjet kjo situatë, ndërkohë që ky aktivitet mund të ushtrohej me kushtin që ditën që aty do të fillojë turizmi elitar, siç mund të jenë hotele të mëdhenj si: Hillton apo Sheraton me 5 yje, ata të largoheshin. Që të ndërtohen hotele të tilla, duhen të paktën 2 vjet dhe personat që do të ushtronin këtë aktivitet me një rimorkiator mund t'i tërhiqnin koshat dhe i t'i zhvendosnin nga Kakomeja në Gjirin e Kasolles, por ne as e kemi zhvilluar turizmin atje dhe as...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua të them se i njëjti fenomen mund të na dalë disa herë. Këto shprehjet që peshku po ndot detin...

Niko Peleshi - Të mos e zgjasim më shumë.

A ka komente të tjera? Nuk ka.

Shumë faleminderit për prezantimin dhe për përgjigjet!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.03.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën"" (*komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Gjetan Gjetani, Arben Pëllumbi, Dritan Bici dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Eglantina Gjermani dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Muharrem Jazaj - kryetar i Shoqatës së Akuakulturës

Vasil Jovani - anëtar i Shoqatës së Akuakulturës

Niko Peleshi - Vazhdojmë me dëgjuesën me grupet e interesit.

Nëse jeni njohur me ligjin dhe keni pasur kohë ta lexoni dhe ta studioni, fjala është për ju.

Muharrem Jazaj – Faleminderit që na dhatë mundësinë të flasim në këtë komision!

Unë, në fakt, kam qenë këtu edhe para dy vjetësh kur është bërë ligji i akuakulturës dhe, kur jam larguar nga komisioni, kam kuptuar që ligji ishte i tillë, që ndalon dhënien e licencave të reja, por nuk e kam kuptuar pse u bllokuan këto që ishin dhe nuk rinovoheshin. Ndoshta unë e kam kuptuar gabim ose janë bërë ndryshime në parlament në kohë të tjera, por unë sot si biznes po e vuaj këtë ndryshim.

Unë kam 15 vjet që bëj këtë biznes, i cili në Shqipëri ka filluar në vitin 2000 dhe nga viti në vit po rritet, sepse edhe tregu i brendshëm po konsumon peshk. Edhe zonat bregdetare, edhe Tirana, por edhe vendet e tjera e kanë futur kulturën e konsumimit të peshkut dhe prodhimeve të detit, që është një lajm i mirë edhe për njerëzit që ushqehen me peshk, por edhe për ne që bëjmë këtë biznes.

Para se të aplikoja për leje te Ministria e Bujqësisë duhet të aplikoja te Ministria e Mjedisit, ku mora lejen pa afat, por, kur shkova te Ministria e Bujqësisë, mësova ngërçin, që licencat nuk rinovoheshin. Më prematuan që do të bëhet licencë e re dhe kaluan ca kohë pa u bërë, por që kam punuar me një shqetësim gjatë kësaj periudhe, sepse jam biznes që bëj eksport dhe kam kontrata me klientë të Bashkimit European, ndaj kam këmbëngulur për ta zgjidhur këtë ngërç. Besoj se ju e keni të qartë që ky ngërç duhet të rregullohet sa më shpejt. Kjo është e para.

E dyta, për sa u përket zonave, është një vendim i kahershëm i Këshillit të Ministrave, ku zonat janë të përcaktuara dhe kanë kriteret të përcaktuara. Kriteri i parë, është që të mbrohen nga stuhitë dhe nga dallgët e detit.

Kriteri i dytë, është parametri i thellësisë. Pra, për këtë aktivitet sa më thellësi të ketë uji, aq më e vogël është ndotja dhe aq më cilësor rritet peshku.

Deri tani nuk është bërë ndonjë gjë gabim, por ka shumë kohë që shteti dhe Ministria e Bujqësisë nuk po u japin përparësi zonave për zhvillimin e peshkut. Kjo duhet të ishte bërë me kohë dhe nuk e di përse nuk po bëhet.

E rëndësishme është që ne të vazhdojmë të punojmë, të bëhet ndoshta një vendim provizor dhe këto zona të përcaktohen sa më shpejt, që edhe ne të dimë se ku do të zhvillohet biznesi i rritjes së peshkut dhe ku do të zhvillohet turizmi.

Mora rastin konkret, sepse ministria e Mjedisit e ka bërë studimin dhe ma ka dhënë lejen, por ky ishte një ngërç institucional, ku vetë ministrinë duhet të merren vesh.

Niko Peleshi – Pra, ju jeni dakord me këtë projektligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Muharrem Jazaj – Po, e zgjidh, por problemi është si shkruhen gjërat, sepse ndryshe i themi këtu dhe ndryshe shkruhen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam kohë që merrem me këtë biznes dhe jam i interesuar direkt, por edhe shumë kolegë të mi. Pra, sa më shpejt të zgjidhet, aq më mirë është për biznesin.

Niko Peleshi – Edhe pika e organizatave të akuakulturës në bashkëpunim me organizatën “Menaxhim Peshkimit”, meqenëse edhe ju jeni organizatë, është një nevojë.

Muharrem Jazaj – Ne jemi, por shteti nuk na shikon, sepse nuk njihemi ligjërisht. Ne bëjmë shkresa dhe dokumente, por na kalojnë, por që të jemi ligjërisht të njohur ashtu siç e ka e gjithë Europa do të ishte më mirë,.

E thashë edhe pak më parë, ne kemi shkuar në Europë me biznes, ndërsa me letra ende. Nuk është e lehtë të çosh produkte peshku në Europë, sepse duhen shumë certifikime dhe standarde të sigurisë ushqimore, të cilat ne i kemi plotësuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, transportoj. Këtë vit kam një kontratë me 1000 tonë peshk për t'i çuar në tregun Italian.

Niko Peleshi – A ka ndonjë pyetje apo koment?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Muharrem Jazaj – Ne kemi edhe një problem, sa u rritëm dhe filluam të tregtojmë në Europë, kanë filluar të dalin probleme të tjera, siç janë kuotat, të cilat deri dje nuk kanë qenë, por tani na janë bërë pengesë.

Ne flasim, por ende nuk shikoj ndonjë rrugëzgjidhje. Ky është problem për biznesin, sepse, nëse unë kam nënshkruar një kontratë me 1000 tonë peshk, gjysmën e do levrek dhe gjysmën e do kocë, me vendosjen e kuotave nga BE-ja, del që levreku ka një kuotë, e cila konsumohet brenda një muaji nga unë dhe kompanitë e tjera që eksportojmë. Ai që blen peshkun kërkon që unë të ul çmimin e peshkut, sepse ai i paguan shtetit italian një taksë 8,5 %. Kjo shkakton debat mes nesh, sepse ai kërkon që këtë taksë ta paguaj unë dhe të punoj pa fitim dhe unë kërkoj ta paguajë ai. Pra, është një ngërç që institucionet duhet ta rregullojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Kristo – Kjo është pjesë e MSA-së. Pra, është e njëjti problem që kemi me açugen, sardelen, krapin dhe levrekun.

Zoti Peleshi e di, sepse i ka dërguar letër zyrtare komisionerit Han, ku i kërkonte rinegociimin e kuotave për açugen e përpunuar, për levrekun, për sardelen, për tonin në kuti e të tjera, pra për të gjithë pjesën e industrisë përpunuese.

Edhe në Komitetin European e kemi ngritur çështjen e kuotave.

Ky proces nuk varet vetëm nga vullneti i ministrisë, por edhe nga ai i palës tjetër. Edhe sikur të bien dakord komisioni me ministrinë ose qeveria shqiptare me Komisionin European, përsëri ky amendament i MSA-së duhet të miratohet në parlamentet e vendeve të Bashkimit European, pasi ka një faturë financiare. Bashkimi European ka vendosur taksën me 8,5 %, që paguan sot klienti i Muharremit, pra, nëse kjo taksë do të hiqet, secili vend anëtar duhet të planifikojë që këto të ardhura nuk do të shkojnë më në buxhetin e tyre. E para.

E dyta, meqenëse do të jetë një negociatë, ato të ardhura që nuk i merr nga taksa doganore e peshkut, do të kërkohej që ne të liberalizojmë një produkt tjetër, për shembull, qumështin, ku ne kemi taksë doganore. Pra, është një çështje që, nëse liberalizohet ky sektor 100%, humbja është 10 apo 15 milionë euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

MSA-ja është negociuar në vitin 2005. Në këtë vit akuakultura ishte minimale. Në maj të vitit 2005 MSA përfundoi, por kishte ngelur pezull pa u mbyllur vetëm me çështjen e açuges. Kur riedhi propozimi në nëntor të vitit 2005 i pandryshuar, ku pala shqiptare nuk kishte rënë dakord dhe nuk e kishte pranuar, u bë një vendim politik i qeverisë shqiptare dhe u ra dakord ta pranonin, sepse ishte ndryshuar qeveria. Qeveria e parë e kishte negociuar, ndërsa qeveria tjetër pranoi vetëm që ta firmoste MSA-në. Pra këto janë edhe pasojat për açugen dhe për pjesën tjetër që sot kemi

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo pjesë ishte politike, sepse më takon ta bëj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është vetëm për levrekun, ndërsa për kocen nuk është, megjithatë kjo është në negociatë. Studimin shpresojmë ta përfundojmë në fund të këtij viti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Situata është e tillë. Ne u anëtarësuam në OBT në vitin 2002.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në kuadër të OBT-së, doganën për peshkun e kemi bërë zero. Pra, peshku që futet në Shqipëri nuk ka doganë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne me Bashkimin European kishim pak për të negociuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë dua të them. Në momentin kur ne kemi filluar negociatat e MSA-së, për eksportet e produkteve tona, ne nuk kishim se çfarë peshku të ofronim, nëse kisha levrekun e BE-së me 10 lekë, do të negocionim që ne ta bëjnë zero dhe ai ta bënte zero. Kur ne doganën e kishim me zero, ne duhet t'i luteshim që edhe ata ta bënin zero.

Bashkimi European e ka taksën doganore për të gjitha llojet e peshqve, por ka shtete siç ka bërë me Shqipërinë, ku të gjitha prodhimet e peshkut e kanë doganën zero, me përjashtim të prodhimet e akuakulturës si: levreku, açugia e përpunuar, sardelja e përpunuar, krapi, trofta, e të tjera me radhë. Pra, ka bërë përjashtime sipas interesave të ekonomive që ai ka. Ka bërë akuakulturën e levrekut me bllokim, sepse Greqia ka akuakulturë, sepse Italia ka bërë troftën, prandaj ka vendosur kuotë, ka bërë açugen, sepse ka industri përpunuese në Itali dhe në Kroaci. Bizneset italiane dhe kroate kanë investuar në Tunizi dhe në Marok dhe këto investime do t'i mbrojnë prandaj ka vendosur kuotë. Pra, që unë ta bëja zero duhet t'i thosha: "Në mënyrë që unë ta bëj levrekun tënd, ti ma bëj mua zero levrekun tim". Prandaj, e nisa këtu historinë, sepse kur unë e kisha zero, nuk kisha se çfarë t'i ofroja dhe më mbetej vetëm t'i ofroja domatet, por edhe për domatet do të dilte dikush tjetër dhe do të më thoshte: "Prit se po na shkatërron prodhimin bujqësor". Kështu, kjo është arsyeja.

Niko Peleshi – Lidhur me pyetjet që bëri zoti Baraj, dua t'ju them mirë që keni gjetur këtë komisionin, që mund flisni sa të doni, sepse nuk besoj se ka komision tjetër që e lejon këtë gjë.

Vasil Jovani - Në fakt, unë kam dy probleme, që i kam hasur te biznesi im.

E para, shteti shqiptar nuk ka politika mbështetëse dhe stimuluese për prodhimin vendas. Unë kam 15 vjet që punoj në këtë sektor dhe kam zero investime. Zoti Denis e di shumë

mirë që unë kam kontaktuar dhe kam bërë letra, por përsëri jam me zero investime. Unë ndihem keq për këtë pjesë, sepse nuk kam përfituar asgjë dhe jam i shqetësuar për këtë kur shteti e ngre me të drejtë. Unë kam rritur punësimin, sepse sot kam gati 40 veta ...

Niko Peleshi – A keni aplikuar tek IPARD-i, sepse nga IPARD-i nuk kanë dalë ende përgjigjet?

Rolnd Kristo – IPARD-i u përjashtua për faktin e *turn over*-it...

Tani ministria po diskuton për ta rritur çështjen e tavanit.

Niko Peleshi – Megjithatë kjo nuk ka fund...

Vasil Jovani – Unë i kam bërë letrat, kam aplikuar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk kam përfituar asnjëherë. Po ju them rastin e fundit: në vitin 2017 unë e kisha kuotën...

(Diskutime pa mikrofon.)

Këto që kanë ndodhur janë biznese me kapital të huaj, kurse unë jam 100% me kapital vendas dhe kam nevojë për ndihmën e shtetit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, pse nuk kam përfituar?! Sepse ata që merren me letrat nuk i bëjnë mirë. Ata thonë kuota deri në 2 milionë euro, kurse unë, në vitin 2017, e kam pasur xhiron 2,5 milionë euro dhe nuk u kualifikova.

(Diskutime pa mikrofon.)

Niko Peleshi - Në rregull!

Të gjitha diskutimet qëndrojnë, por nuk mund ta zgjasim sot bisedën, sepse është parashikuar që të zhvillojmë vetëm këtë projektligj. Ne jemi të gatshëm në çdo rast (në qoftë se mendoni që mund të japim një kontribut, sepse tani është më e thjeshtë kur nuk e ke vetë përgjegjësinë në kurriz), që të bëjmë një dëgjese edhe me sektorin tuaj. Pra, na thoni çfarë çështjesh keni dhe mund t'i ngrini me ne.

Vasil Jovani – Pas miratimit të ZPA-së për këtë gjë, ne që kemi licencë dhe do të vazhdojmë të jemi të licencuar të mos kemi kufij 10-vjeçarë, por me kërkesën tonë të vihet pa afat.

Së dyti, në qoftë se do të ketë projekte te zonat tona, sepse ne ende nuk e dimë se cilat zona do të miratohen dhe cilat nuk do të miratohen, të krijohet një komision lidhur me prishjen e bizneseve tona, duke llogaritur edhe uljet nga koha që kanë shërbyer në funksionin tonë, pra të krijohet një komision për dëmshpërblim. Ne të gjithë jemi dakord që të prodhosh peshk në det, duke mos pasur as rrugë, as ujë, as drita, në detin tonë të egër, ka shumë shpenzime për të bërë një biznes të tillë.

Niko Peleshi – Dakord, por në momentin që je jashtë kontratës, shteti nuk mund të marrë përsipër detyrime që nuk i ka kontraktuale.

Vasil Jovani - Mund të dalë diçka emergjente, siç tha zotëria më parë, dhe shteti do të thotë që këto do të shkojnë vërtet për naftë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Roland Kristo – Ligji aktual thotë që e ke 10, 15 dhe 20-vjeçare në varësi të formës së investimit.

Së dyti, në qoftë se ti je në rregull me detyrimet kontraktore, automatikisht të rinovohet leja. Qëllimi qëndron vetëm që të mos ketë burokraci, sepse shteti nuk mund të ta japë ty lejen për 100 vjet apo pa afat.

Vasil Jovani – Ne kështu e kishim edhe me ligjin e parë.

Roland Kristo – Jo, nuk e kishe kështu.

Ky ligj e ka, por ne nuk ta rinovonim dot, sepse kishte dispozitën bllokuese. Ky ligj thotë 3 muaj para bëj kërkesën dhe automatikisht të rinovohet leja, kurse ligji nr.7908 e ka pasur që nëse ty të mbaron afati, atëherë hap krahun dhe futu në prokurim publik, se nuk i dihet.

Niko Peleshi – Pra, shqetësimi juaj e merr përgjigjen te projektligji dhe ajo pikë e projektligjit nuk preket nga këto ndryshime, apo jo? Pra, kjo është zgjidhur në ligjin e kaluar. Pengesa që keni pasur deri tani ka qenë kushti për studimin ZPA-ve. Ky kufizim tani po hiqet ose po krijohet një dispozitë transitore, ku ju do të vazhdoni për inerci derisa të dalë studimi.

Në momentin kur ju ta merrni lejen, bazuar në këtë ligj dhe te studimi i miratuar, atëherë mund ta rinovoni automatikisht pasi të mbarojë afati i kontratës, mjafton që ju të bëni kërkesën, siç e ka ligji. Pra, ne nuk po e prekim këtë pikë. Besoj se nuk ka komente të tjera.

Për sa i përket ministrisë është me shumë vend vërejtja që bëri në fillim zoti Beqja, që projektligje të tilla, sidomos për sektorë që nuk janë kaq të njohur ose popullorë, mirë do të ishte

që komisioni të ketë një relacion paraprak për sektorin ku jemi, si kemi qenë, si është dinamika e zhvillimit të sektorit, cilat janë potencialet e zhvillim e të tjerë. Kjo gjë do të na fusë më shumë në kontekst dhe do t'u shërbejë edhe anëtarëve të komisionit për të vlerësuar më mirë projektligjin.

Ne sot do ta miratojmë projektligjin në parim nëse komisioni do të bjerë dakord. Disa vërejtje qëndrojnë dhe mund të reflektohen, pa prishur thelbin e projektligjit, por do t'i diskutojmë në mbledhjen tjetër, kur ta kalojmë nen për nen. Unë jam konsultuar me shërbimin e komisionit dhe me të vërtetë që neni i fundit mund të jetë një dispozitë kalimtare dhe jo një ndryshim i nenit aktual.

Pra, nuk ndryshon asgjë, thjesht është teknikë legislative, por duket më korrekte. Gjithashtu, edhe kriteret janë vazhdim i një paragrafi të nenit, mund të jenë më të qarta dhe të mos lenë vend për ekuivokë, ndonëse edhe ekuivokët mund të zgjidhen me ndonjë VKM në zbatim të tij. Pra, sa më i qartë të jetë ligji, aq më i mirë është edhe për kriteret e vazhdimit të kontratës. Unë jam dakord që duhet të jenë sa më burokratike, në mënyrë që të shmangim edhe mundësitë për abuzime, sepse sa herë që ka burokraci ka një mundësi për të abuzuar dhe kjo krijon edhe dhimbje koke për biznesin. Pra, këto do t'i diskutojmë kur të shkojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 “Për akuakulturën””?

Kundër?

Nuk ka.

Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet projektligji në parim.

Seanca e ardhshme, ditën e hënë, do ta miratojmë nen për nen dhe në tërësi.

Falënderoj përfaqësuesit e ministrisë dhe përfaqësuesit e grupit të interesit!

MBYLLET MBLEDHJA

